



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br _____ 57/24
Nr. i fq. / Br. sf _____ - 1 -
Data: / Datum _____ 28.03.2024
VUSHTRRI - VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **28 mars 2024**, merr këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIM PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E VUSHTRRISE PËR PERIUDHËN 2024-2026

1. Me këtë vendim aprovet Plani Lokal për Veprim për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2024-2026.
2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave në avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali si komunitete pakicë në Komunën e Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Lokal për Veprim për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2024-2026.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi



Kryesuese i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRIN

01 Nr. / Br 58/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data / Datum 28.03.2024

VUSHTRRI - VUÇITRIN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" dhe 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.4, 18 paragrafi 1 pika 1.13 dhe 19 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01nr.126/17 për Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **28 mars 2024**, merr këtë:

VENDIM


PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZAT (GROPOSJEN) E KAFSHËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për varreza (groposjen e kafshëve) në pjesë të parcelës kadastrale P-70202027-00001-1, në sipërfaqe prej 1000 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 664806 m², kualiteti i klasës kullosë e KL. 5, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi



Kryesuese i Kuvendit



Republika e Kosovës


Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:


V E N D I M
PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM “SHTËPI MUZE”
TË SHTËPISË SË KAHRIMAN PASOMES

1. Me këtë vendim shpallet me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” shtëpia e Kahriman Pasomes, pronë e Xhezair (Kahriman) Pasomes, e regjistruar në certifikatën e pronësisë P-70202016-00964-1, vendi i quajtur “Varosh/Sitniçka” me kulturë “Shtëpi” në sipërfaqe prej 50 m², Zona Kadastrale Vushtrri.
2. Obligohet Kryetari i Komunës që për paluajtshmërinë nga pika paraprake e këtij vendimi si dhe oborrin e shtëpisë të zhvilloj procedurat e shpronësimit konform legjislacionit në fuqi për shpronësim të pronës së paluajtshme. Para fillimit të procedurave të shpronësimit të përgatitet elaborat i detajuar duke përcaktuar sipërfaqen e tërësishme e cila është e nevojshme të shpronësohet.
3. Kryetari i komunës do të ndërmerr masa të nevojshme që të fillohet me përgatitje të projektit për renovim/konservim, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm.
4. Kryetari i komunës do të kujdeset për planifikim të mjeteve buxhetore për vitin 2025, për implementim të këtij vendimi.
5. Objekti “Shtëpi Muze” dhe hapësira ngjitas saj e përcaktuar në projekt dhe aprovuar me këtë vendim, pas përfundimit të procedurave të shpronësimit do të kalojë në pronësi dhe menaxhim të Komunës së Vushtrrisë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
7. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës –Vushtrri

Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM “SHTËPI MUZE” TË SHTËPISË SË SELATIN GËRXHALIUT, PRONË E NEXHMEDIN GËRXHALIUT

1. Me këtë vendim shpallet me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” shtëpia e Selatin Gërxhaliut, pronë e Nexhmedin (Xhelil) Gërxhaliut, e regjistruar në certifikatën e pronësisë P-70202027-00401-2, vendi i quajtur fshat, me kulturë “shtëpi” në sipërfaqe prej 127 m², Zona Kadastrale Studime e Poshtme.
2. Obligohet Kryetari i Komunës që për paluajshmërinë nga pika paraprake e këtij vendimi si dhe oborrin e shtëpisë të zhvilloj procedurat e shpronësimit konform legjislacionit në fuqi për shpronësim të pronës së paluajtshme. Para fillimit të procedurave të shpronësimit të përgatitet elaborat i detajuar duke përcaktuar sipërfaqen e tërësishme e cila është e nevojshme të shpronësohet.
3. Kryetari i komunës do të ndërmerr masa të nevojshme që të fillohet me përgatitje të projektit për renovim/konservim, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm.
4. Kryetari i komunës do të kujdeset për planifikim të mjeteve buxhetore për vitin 2025, për implementim të këtij vendimi.
5. Objekti “Shtëpi Muze” dhe hapësira ngjitas saj e përcaktuar në projekt dhe aprovuar me këtë vendim, pas përfundimit të procedurave të shpronësimit do të kaloi në pronësi dhe menaxhim të Komunës së Vushtrrisë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
7. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRËN

01 Nr. / Br 61/24

Nr. i fq. / Br. st - 3 -

Data / Datum 28.03.2024

VUSHTRRI - VUÇITRËN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 6 pika 1.1, nenit 8 pika 1.1 dhe nenit 14 pika 1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 5 pika 1.2, nenit 6 pika 3 dhe nenit 8 të Rregullores Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 13 paragrafi 1.4 dhe nenit 19 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M P A R A P R A K

për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronave të paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcelat kadastrale si në vijim:

- 1.1. Parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m², P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m², P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m², ZK Navalan, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.2. Parcela P-70202053-00366-1 në sipërfaqe prej 25436m², ZK Prelluzhë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.3. Parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m², parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m², parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m², ZK Kollë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.4. Parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m², ZK Dumnicë e LLugës, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.5. Parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m², ZK Gjelbishtë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

1.6. KIOSKAT NË QENDER TË QYTETIT (Shfrytëzim deri 15 vite)

1.6.1. KIOSKA NR. 1 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PËRKOHSHËM

1.6.2. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
Parcela- 00653-0;

1.6.3. KIOSKA NR. 2 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.4. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.5. KIOSKA NR. 3 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.6. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.7. KIOSKA NR. 4 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.8. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.9. KIOSKA NR. 5 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.10. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.11. KIOSKA NR. 6 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.12. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.13. KIOSKA NR. 7 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.14. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.15. KIOSKA NR. 8 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.16. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.17. KIOSKA NR. 9 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.18. Lokacioni i kioskës- sheshi “Hasan Prishtina”, sipërfaqja e kioskut: 12 m²
parcela- 00653-0;

1.6.19. KIOSKA NR. 10 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.20. Lokacioni i kioskës- sheshi "Hasan Prishtina", sipërfaqja e kioskut: 12 m² parcela- 00653-0;

1.6.21. KIOSKA NR. 11 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.22. Lokacioni i kioskës- sheshi "Hasan Prishtina", sipërfaqja e kioskut: 12 m² parcela- 00653-0;

1.6.23. KIOSKA NR. 12 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.24. Lokacioni i kioskës- sheshi "Hasan Prishtina", sipërfaqja e kioskut: 12 m² parcela- 00653-0;

1.6.25. KIOSKA NR. 13 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.26. Lokacioni i kioskës- sheshi "Hasan Prishtina", sipërfaqja e kioskut: 12 m² parcela- 00653-0;

1.6.27. KIOSKA NR. 14 LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

1.6.28. Lokacioni i kioskës- sheshi "Hasan Prishtina", sipërfaqja e kioskut: 12 m² parcela- 00653-0;

2. LOKALI AFARIST, i cili gjendet në parcelën kadastrale 127-0, zk Vushtrri, Rr. "Dëshmorët e Kombit", në sipërfaqe prej 90m²;

3. LOKAL AFARIST, i cili gjendet në parcelën kadastrale nr.86-0, ZK Vushtrri, rr."Ismajl Qemajli" Vushtrri në sipërfaqe prej 39m².


4. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

5. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

6. Ky vendim paraprak hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 6 pika 1.2, nenit 8 pika 1.1 dhe nenit 14 pika 1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 5 pika 1.3, nenit 6 pika 3 dhe nenit 13 të Rregullores Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 13 pika 1.4 dhe nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M P A R A P R A K

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronave të paluajtshme të komunës së Vushtrrisë, parcelat kadastrale në vijim:

- 1.1. Parcela kadastrale P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m², ZK Stanovc i Poshtëm, në afat prej 99 vite, përmes konkursit publik për shprehje të interesit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.2. Pjesë nga Parcela P-70202016-00001-1 me sipërfaqe prej 3000m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 14732m², ZK Vushtrri, në afat prej 99 vite përmes konkursit publik- për shprehje të interesit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.3. Pjesë nga Parcela P-70202016-01129-1 me sipërfaqe prej 60m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22493m², ZK Vushtrri, në afat prej 99 vite përmes konkursit publik- për shprehje të interesit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.4. Pjesë; nga parcela kadastrale P-70202028-00614-0 me sipërfaqe prej 2000m², nga sipërfaqja përgjithshme prej 15795m², ZK Stanovc i Poshtëm, në afat prej 99 vite, përmes konkursit publik për shprehje të interesit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.5. Parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m², ZK Stanovc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes shprehjes së interesit të personave fizik dhe juridik për veprimtari afariste.


2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvilloj procedurat për shprehjen e interesit si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe

mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të shprehjes së interesit dhe menaxhimit të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

3. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim paraprak hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, si dhe nenin 41 paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIM TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1.Kushtrim Hyseni, anëtar i Kuvendit;
- 1.2.Shkelzen Xhaferi, anëtar i Kuvendit;
- 1.3.Remzi Ahmeti, nga ekzekutivi i komunës;
- 1.4.Benjamin Shala, nga ekzekutivi i komunës;
- 1.5.Isak Hyseni, nga shoqëria civile.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për pronën/at e përfshira në vetëm një vendim paraprak të kuvendit të komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për pronën e paluajtshme të komunës e cila jepet në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit,

4.1.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, në vendin ku gjendet prona e komunës e cila jepet në shfrytëzim dhe së paku në njërin nga mediat e shkruara dhe elektronike.

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e pronës, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit,

arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.

4.2 Pas pranimit të ofertave Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, ndërsa brenda 15 ditësh për rastet e dhënies në shfrytëzim afatgjatë.

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces.

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin, për rastet me periudhë shfrytëzimi afatshkurtër. Për rastet me periudhë të shfrytëzimit afatgjatë ofertën e përzgjedhur e procedon në kuvendin e komunës për aprovim.

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.


5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, si dhe nenin 41 paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIM TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në këtë përbërje:

- 1.1.Zojë Hajrizi, anëtare e Kuvendit;
- 1.2.Agim Bregaj, anëtar i Kuvendit;
- 1.3.Remzi Ahmeti, nga ekzekutivi i komunës;
- 1.4.Benjamin Shala, nga ekzekutivi i komunës;
- 1.5.Isak Hyseni, nga shoqëria civile.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për pronën/at e përfshira në vetëm një vendim paraprak të kuvendit të komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat për dhënie e pronës në shfrytëzim sipas modalitetit të shprehjes së interesit përmes konkursit publik për pronën e paluajtshme të komunës e cila jepet në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit,

4.1.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, në vendin ku gjendet prona e komunës e cila jepet në shfrytëzim dhe së paku në njërin nga mediat e shkruara dhe elektronike.

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e pronës, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit,

arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku bëhet hapja e ofertave.

4.2 Pas pranimit të ofertave Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, ndërsa brenda 15 ditësh për rastet e dhënies në shfrytëzim afatgjatë.

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces.

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin, për rastet me periudhë shfrytëzimi afatshkurtër. Për rastet me periudhë të shfrytëzimit afatgjatë ofertën e përzgjedhur e procedon në kuvendin e komunës për aprovim.

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRËN	
01 Nr. / Br	65/24
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	28.03.2024
VUSHTRRI - VUÇITRËN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **28 mars 2024** merr këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon:

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.9, z. Ejup Haziri, caktohet anëtar i KKSB-së kurse z.Shemsi Rrahimi, pushon të jetë anëtar i KKSB-së, sipas nenit 4, pika 1.9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit